



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

PROJEKT

DRAFT-RREGULLORE
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË NDRYSHIMEVE NË
STRUKTURËN E PRONËSISË DHE TRANSPARENCËN E TË DHËNAVE TË
LIDHURA ME PRONËSINË TË OSHMA-VE”¹

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

1. Kjo rregullore hartohet në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Kjo rregullore del në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, Ligjit nr. 112/2020, datë 29.07.2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kritereve dhe procedurave për:
 - a) Shqyrtimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore brenda të njëjtit person juridik OSHMA privat, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi.
 - b) Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privatë OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi.
 - c) Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronësisë së personit juridik OSHMA mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues.

¹ Kjo rregullore përafrohet në formë fillestare me Rregulloren e propozuar të Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Mbi krijimin e një kuadri të përbashkët për shërbimet e medias në tregun e brendshëm (Akti Evropian për Lirinë e Medias), që ndryshon Direktivën 2010/13/BE”, {2022/0277 (COD)}.

- d) Deklarimin e ndryshimeve në disa të dhëna të tjera të licencës/autorizimit të lidhura me pronësinë, në momentin e aplikimit për ndryshime në strukturën e pronësisë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për transmetuesin publik shqiptar (RTSH).

Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive, autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. “Person juridik privat” janë subjektet raportuese nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë të regjistruar në QKB në një nga format si më poshtë:
 - a) shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar;
 - b) shoqëritë aksionare;
 - c) shoqëritë kolektive;
 - ç) shoqëritë komandite;
 - d) zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja;
 - e) çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së;
 - f) organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;
 - g) personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionarët e të cilëve, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, janë edhe persona fizikë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj.
 - gj) bashkësitë fetare.
 - h) përfaqësitë diplomatike të huaja në Republikën e Shqipërisë.
3. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
4. “Ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove (OPSHV)” është personi juridik i cili ofron shërbimin e platformës së shpërndarjes së videove.
5. “Reklama” është çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person fizik për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës.
6. “Reklama institucionale” janë reklamat e porositura nga një institucion shtetëror, për të promovuar veprimtarinë e institucionit, me qëllim që të nxisë, të përkrahë dhe mbrojë vlerat dhe qëndrimet që konsolidojnë demokracinë, mirëqenien, shëndetin publik dhe sigurinë kombëtare.
7. “Reklama politike” janë reklama me përmbajtje thelbësore politike, që kanë për qëllim të arrijnë objektiva politikë.
8. “RTSH” është Radio e Televizioni Shqiptar, person juridik publik jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive.

9. "Sponsorizim" është çdo kontribut i bërë nga një person juridik publik ose privat ose nga një person fizik, i cili nuk është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve audiovizive ose në prodhimin e veprave audiovizive, ose në shërbimin e platformës së shpërndarjes së videove, për të financuar shërbimet ose programet e medias audiovizive, shërbimet e platformës së shpërndarjes së videove, videot e krijuara nga përdoruesi ose programet me qëllim për të promovuar emrin, markën, imazhin, veprimtarinë ose prodhimet e atij personi juridik ose fizik.
 10. "Pronar përfitues" është personi fizik i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit personin juridik OSHMA, në emër të të cilit po kryhet një transaksion ose veprimtari dhe përfshin të paktën:
 - a) Personin fizik, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të një përqindje të mjaftueshme të aksioneve/kutoave ose të drejtave të votimit ose të pjesëmarrjen në kapitalin e atij personi juridik, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij.
 - b) Themeluesin ose administratorin, ose personin fizik që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia në të cilën një person fizik:
 - i) përcakton vendimet e marra nga organizata jofitimprurëse;
 - ii) kontrollon në çdo mënyrë zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse.
 11. "Pronësi direkte" është pronësia e mbajtur nga një person fizik ose juridik, sipas kufizimeve të nenit 4 të kësaj rregulloreje mbi pjesëmarrjen me aksione/kuota të kapitalit ose të interesave pronësore, në një person juridik OSHMA që:
 - a) është licencuar për ofrimin e transmetimeve audio/audiovizive kombëtare/rajonale/lokale.
 - b) është autorizuar për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe/ose ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të mbështetur në rrjet satelitor.
- Pronësi direkte do të konsiderohet edhe pronësia e mbajtur nga një person fizik ose juridik nëpërmjet çdo aksioni/kuote të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një person juridik OSHMA, mbajtës të çdo autorizimi të parashikuar nga ligji nr. 97/2013, i ndryshuar.
12. "Pronësi indirekte" është pronësia e mbajtur ose kontrolli i ushtruar nga një ose më shumë persona fizikë, në një ose më shumë persona juridikë OSHMA, që:
 - a) është/janë licencuar për ofrimin e transmetimeve audio/audiovizive kombëtare/rajonale/lokale.
 - b) është/janë autorizuar për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe/ose ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të mbështetur në rrjet satelitor, dhe i cili/të cilët mbajnë aksione/kuota të kapitalit ose të interesave të pronësisë sipas kufizimeve të specifikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
- Pronësi indirekte do të konsiderohet edhe pronësia e mbajtur ose kontrolli i ushtruar nga një nga një ose më shumë persona fizikë, në një ose më shumë persona juridikë OSHMA, mbajtës të çdo autorizimi të parashikuar nga ligji nr. 97/2013, i ndryshuar.
13. "Regjistri i Pronësisë së OSHMA-ve" është një bazë të dhënash elektronike e administruar dhe publikuar prej AMA-s, në të cilën regjistrohen të dhënat e deklaruara mbi strukturën pronësore

dhe pronësinë përfituese të tyre, me qëllim sigurimin e transparencës sa i takon pronësisë së shoqërive mediatike audio dhe audiovizive.

14. "Shërbim programi audioviziv" është një tërësi programesh audiovizive të çdo lloji dhe që përhapet ose shpërndahet drejtpërsëdrejti ose jo për marrjen nga publiku i gjerë.
15. "QKB" është Qendra Kombëtare e Biznesit, funksionet e së cilës rregullohen sipas ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 4

Kufizime të pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio dhe licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative.
3. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.
4. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv.
5. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio dhe licenca lokale apo rajonale e shërbimit të transmetimit audioviziv u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
6. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.
7. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.
8. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale.
9. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.
10. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv të mbështetura në rrjete satelitore.
11. Asnjë zotëruar i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv

dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të këtij ligji, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. AMA monitoron dhe publikon informacion periodik mbi volumin e reklamave të transmetuara nga OSHMA-të kombëtare.

KREU II

DETYRIMET E SUBJEKTEVE PËR NJOFTIM TË NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS PRONËSORE

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ofruesve të shërbimeve mediatike audio/audiovizive

1. Ofruesit e shërbimeve mediatike audio/audiovizive në Republikën e Shqipërisë kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike pa pengesa, përfshirë kryerjen e ndryshimeve në strukturën pronësore të personit juridik të tyre, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për mediat audiovizive.
2. AMA e respekton lirinë editoriale të OSHMA-ve dhe nuk ushtron inspektime në mjediset fizike të zyrave të OSHMA-ve dhe ato private, ose, nëse është e zbatueshme, ndaj anëtarëve të familjes së tyre, punonjësit e tyre ose anëtarët e familjes së punonjësve të tyre, me arsyetimin se ata refuzojnë të zbulojnë informacion mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën pronësore.
3. Pavarësisht specifikimit të pikës 2 të këtij neni, AMA ka të drejtë të monitorojë kryesisht dhe në mënyrë periodike në Regjistrin e QKB-së mbi çdo ndryshim të ndodhur në strukturën pronësore apo në të dhëna të tjera të licencës/autorizimit të OSHMA-së. Në rast evidentimi të ndryshimeve në të dhënat e licencës/autorizimit për të cilat nuk është njoftuar Autoriteti, sipas procedurës dhe afatit në nenin 7 të kësaj rregulloreje, zbatohen parashikimet e nenit 15 të saj.

Neni 6

Kriteret dhe dokumentacioni

1. Administratori i personit juridik OSHMA që ka kryer ndryshime në strukturën e pronësisë, ose në rastin e bashkimit të dy ose më shumë personave juridikë, ku të paktën njëri prej tyre është OSHMA, administratori i secilit person juridik, duhet të paraqesë në AMA:
 - B. Njoftim me shkrim për ndryshimin e strukturës pronësore**, ku të deklarohet se transaksioni nuk është në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - C. Të dhëna për strukturën e mëparshme të pronësisë të OSHMA-së, sipas miratimit të AMA-s, ku të përfshihen:**
 - a. Ekstraktin e Thjeshtë dhe Historik të Regjistrit Tregtar, për të dhënat e shoqërisë, ku të reflektohet emri tregtar i personit juridik OSHMA, ose në rastin e bashkimit të dy ose më shumë personave juridikë, emrat tregtarë të secilit prej tyre, përpara kryerjes së ndryshimeve.
 - b. Numri/Numrat e Identifikimit të Personit/ave të Tatuashëm (NIPT).

- c. Selia qendrore e personit juridik OSHMA, ose në rastin e bashkimit të dy ose më shumë personave juridikë, adresën e selisë së secilit prej tyre përpara kryerjes së ndryshimeve.
- d. ***Nëse struktura e mëparshme pronësore të OSHMA-së përbëhet nga persona fizikë:***
 - i. Ekstraktin e Thjeshtë dhe Historik të Regjistrimit Tregtar, për të dhënat e shoqërisë, ku të reflektohet emri dhe mbiemri i ortakëve/aksionarëve;
 - ii. Numri Unik Identifikues i secilit ortak/aksionar
 - iii. Pjesëmarrja e plotë në kapital për secilin ortak/aksionar.
 - iv. Deklaratë mbi llojin e pronësisë:
 - Direkte
 - Indirekte
- e. ***Nëse struktura e mëparshme pronësore të OSHMA-së përbëhet nga persona juridikë:***
 - i. Ekstraktin e Thjeshtë dhe Historik të Regjistrimit Tregtar, për të dhënat e shoqërisë, ku të reflektohet emri tregtar, NIPT-i i personit juridik ortak/aksionar, selia e personit juridik ortak/aksionar,
 - ii. Pjesëmarrja në kapitalin e personit juridik;
 - iii. Emri/emrat e pronarëve përfitues (person fizik) pjesëmarrës në kapitalin e personit juridik;
 - iv. Numri Unik Identifikues i secilit pronar përfitues;
 - v. Pjesëmarrja e plotë e pronarëve përfitues në kapitalin themelor të personit juridik.
 - vi. Deklaratë mbi llojin e pronësisë:
 - Direkte
 - Indirekte

D. Të dhëna që rezultojnë nga ndryshimet e bëra të pronësisë të OSHMA-së, ku të përfshihen:

- a. ***Të dhëna për personat fizikë dhe/ose juridikë që largohen nga struktura e pronësisë së OSHMA-së:***
 - i. Ekstraktin e Thjeshtë dhe Historik të Regjistrimit Tregtar, për të dhënat e shoqërisë, ku të reflektohet emri/emrat e personave fizikë ose emri tregtar (nëse largohet person juridik)
 - ii. Selia (nëse largohet person juridik)
 - iii. Numri Unik Identifikues (në rast se largohet person fizik)
 - iv. Përqindja e kuotave/aksioneve e larguar nga kapitali.
- b. ***Të dhënat për personat fizikë dhe/ose juridikë që i bashkohen strukturës së pronësisë së OSHMA-së:***
 - i. Ekstraktin e Thjeshtë dhe Historik të Regjistrimit Tregtar, për të dhënat e shoqërisë, ku të reflektohet emri/emrat e personave fizikë ose emri tregtar (nëse anëtarësohet një person juridik), jo më i vjetër se 30 ditë nga data e lëshimit.
 - ii. NIPT-i (në rastin e anëtarësimit të personit juridik ortak/aksionar i ri),
 - iii. Selia (nëse anëtarësohet person juridik si aksionar/ortak i ri)
 - iv. Pjesëmarrja e ndryshuar në kapitalin e OSHMA-së, në rast të anëtarësimit të një personi fizik,
 - v. Deklaratë mbi llojin e pronësisë së ndryshuar:
 - Direkte
 - Indirekte

Ose, nëse struktura e re pronësore shtohet me persona juridikë, deklarohet:

- i. emri tregtar,
 - ii. selia,
 - iii. NIPT-i i personit juridik
 - iv. Ortak/aksionar i ri,
 - v. Pjesëmarrja e re e personit juridik në kapitalin e OSHMA-së;
 - vi. Emri/emrat e pronarëve përfitues (person fizik) ortak/aksionar në personin juridik të ri aksionar/ortak;
 - vii. Numri Unik Identifikues i secilit pronar përfitues;
 - viii. Pjesëmarrja e plotë e pronarëve përfitues në kapitalin themelor të personit juridik.
 - viii. Deklaratë mbi llojin e pronësisë:
 - Direkte
 - Indirekte
- c. Kontratë shitje të kuotave/aksioneve, kontratë dhurimi, ose çdo lloj dokumenti tjetër që vërteton kalimin e pronësisë të pala blerëse, të njëzuar me origjinalin.
- d. Nëse një person juridik i huaj i bashkohet strukturës së pronësisë së Subjektet, transmetuesi është i detyruar të paraqesë një dokument për regjistrimin e këtij personi juridik në regjistrin përkatës të vendit të regjistrimit, i cili mund të japë informacion mbi strukturën pronësore dhe administratorin, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit, në origjinal dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i autorizuar ligjor.

E. Të dhëna mbi përputhshmërinë ligjore dhe financiare:

- a. *Në rastet e shitblerjes së kuotave/aksioneve në 15% deri në 45% të pjesëmarrjes në kapitalin e personit juridik të licencuar ose të autorizuar si OSHMA, pala blerëse duhet të deklarojë në AMA:*
 - i. Origjinën e burimeve financiare për kryerjen e transaksionit, që të vërtetuara përkojnë me periudhën e kryerjes së transaksionit tregtar për kalimin e kuotave.
 - i. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të OSHMA-së, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit.
 - ii. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të personit juridik OSHMA, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit;
 - iii. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të pronarëve përfitues, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit.
 - iv. Strukturën e Bordit Drejtues
- b. *Në rastet e shitblerjes së kuotave/aksioneve në më shumë se 45% të kapitalit të personit juridik të licencuar ose të autorizuar si OSHMA, ose të bashkimit me përthithje të dy ose më shumë personave juridikë OSHMA, ose të cedimit të të drejtave që rrjedhin nga licenca/autorizimi, pala blerëse duhet të deklarojë në AMA:*
 - i. Origjinën e burimeve financiare për kryerjen e transaksionit, të vërtetuara që përkojnë me periudhën e kryerjes së transaksionit tregtar për kalimin e kuotave.
 - ii. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të OSHMA-së, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit.

- iii. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të personit juridik OSHMA, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit;
 - iv. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të pronarëve përfitues, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e lëshimit;
 - v. Strukturën e Bordit të ri Drejtues
 - vi. Curriculum Vitae të personit juridik OSHMA;
 - vii. Curriculum Vitae të aksionarëve / ortakëve të personit juridik OSHMA;
 - viii. Curriculum vitae të pronarëve përfitues
 - ix. Vërtetim prej institucioneve tatimore dhe/ose sigurimeve shoqërore mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat etj, të derdhura në favor të ortakëve/aksionarëve;
 - x. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas parashikimeve të kuadrit rregullator të AMA-s mbi procedurat e licencimit dhe/ose autorizimit.
 - xi. Miratimin prej Autoritetit të Konkurrencës për kryerjen e ndryshimeve (vetëm në rastet e OSHMA-ve mbajtëse të licencave)
- c. *Në rastet të cilat sjellin për pasojë ndryshimin tërësor të strukturës pronësore të personit juridik licencuar/autorizuar si OSHMA (bashkim me përthithje, cedim të të drejtave që rrjedhin nga licenca/autorizimi), krahas kritereve të parashikuara si më sipër, pala blerëse duhet të ndjekë edhe detyrimet që burojnë nga neni 9 i kësaj rregulloreje.*

F. Të dhëna të tjera:

- a. Në të gjitha rastet e ndryshimit të strukturës pronësore, pala blerëse deklaron nëse ka lidhje apo konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në organizata të tjera ose shoqëri private, vetëm në rastet kur kjo ndikon drejtpërdrejtë në ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive.
 - b. Në të gjitha rastet e ndryshimit të strukturës pronësore, pala blerëse dhe shitëse deklarojnë llojet e të ardhurave financiare, përfshirë nëse është rasti, informacion mbi sponsorizime, reklama, donacione, investime, nga persona juridikë publikë, me qëllim për të promovuar veprimtaritë e atij personi juridik, sipas formularit në Shtojcën nr. 1.
 - c. Në rastet të cilat sjellin për pasojë ndryshimin tërësor të strukturës pronësore të personit juridik licencuar/autorizuar si OSHMA (bashkim me përthithje, cedim të të drejtave që rrjedhin nga licenca/autorizimi), pala blerëse duhet të deklarojë në AMA ndryshimet në objektin e veprimtarisë së personit të ri juridik OSHMA, ku të reflektohet si objekt ekskluziv ushtrimi i veprimtarisë audio/audiovizive.
 - d. Në të gjitha rastet e ndryshimit të strukturës pronësore, pala shitëse duhet të deklarojë fakte që vërtetojnë ndryshimin ose shuarjen e të drejtave pronësore mbi personin juridik licencuar/autorizuar si OSHMA, në rastin e vendosjes së uzufuktit, pengut, sekuestrimit, konfiskimit, ose çdo situatë tjetër ligjore që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjen mbi aksionet/kuotat në kapital.
2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, depozitohet origjinal ose i njehsuar me origjinalin dhe nuk i kthehet aplikuesit pas dorëzimit të tij në institucion.

- Dorëzimi mund të kryhet nëpërmjet postës ose dorazi, në zyrën e protokollit të AMA-s.
3. Administratori i personit juridik OSHMA që ka kryer ndryshime në strukturën e pronësisë, ose në rastin e bashkimit të dy ose më shumë personave juridikë, ku të paktën njëri prej tyre është OSHMA, administratori i secilit person juridik dorëzon edhe formularin e veçantë të aplikimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas Shtojcës nr. 1, së bashku me dokumentacionin shoqërues së pikës 1 të këtij neni.
 4. Formulari i aplikimit është pjesë përbërëse e dokumentacionit të aplikimit dhe mund të shkarkohet nga aplikuesi në faqen zyrtare në internet të AMA-s, ose mund të tërhiqet pa pagesë pranë zyrave të AMA-s. AMA miraton përmbajtjen dhe formën e formularëve të aplikimit, sipas Shtojcave bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 7

Afati i kryerjes së njoftimit mbi ndryshimet në pronësi dhe pagesa

1. Subjektet, në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë të detyruar që njoftimin për ndryshimin e strukturës pronësore t’u dorëzojnë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive jo më vonë se 30 ditë nga data e kryerjes së ndryshimeve, së bashku me dokumentacionin shoqërues sipas nenit 6.
2. Pagesa për përpunimin e dokumentacionit (PPD) për ndryshimet në pronësi kryhet sipas parashikimeve të rregullores në fuqi për pagesat për licencë ose autorizim dhe shërbimet që kryhen nga AMA, brenda 3 ditëve pune nga momenti i depozitimit të aplikimit në institucion dhe tërheqjes së faturës.

Neni 8

Njoftim në rast ndryshimesh në të dhëna të tjera të licencës/autorizimit

1. Krahas rasteve të ndryshimeve të strukturës pronësore, OSHMA-të janë të detyruara të njoftojnë AMA-n edhe për raste të ndryshimeve në të dhënat e licencës/autorizimit për:
 - a) Ndryshimin e emrit të subjektit tregtar
 - b) Emrin e subjektit të ofrimit të shërbimit programor audioviziv (OSHMA-së)
 - c) Ndryshim të formës ligjore të personit juridik, ose kalimit nga person fizik në atë juridik.
 - d) Ndryshime në adresën e selisë, administratorit, adresës zyrtare fizike dhe elektronike, etj
2. Sipas pikës 1, aplikuesi depoziton në AMA:
 - a) Kërkesë me shkrim;
 - b) Autorizimin e institucionit publik përgjegjës për përdorimin e logos, në rastin e ndryshimit të emrit të ofrimit të shërbimit programor audioviziv (OSHMA-së).
3. Administratori i personit juridik OSHMA dorëzon edhe formularin e veçantë të aplikimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas Shtojcës nr. 2, së bashku me dokumentacionin shoqërues sipas pikës 1 të këtij neni.
4. Pagesa për përpunimin e dokumentacionit (PPD) për ndryshimet në të dhëna kryhet sipas parashikimeve të rregullores në fuqi për pagesat për licencë ose autorizim dhe shërbimet që kryhen nga AMA.

KREU III

PROCEDURA E APLIKIMIT NË RASTE TË KALIMIT TË TË DREJTAVE TË LIDHURA ME LICENCËN OSE AUTORIZIMIN

Neni 9

Mënyra dhe afati i aplikimit për cedimin e të drejtave që rrjedhin nga ndryshimet në pronësi

1. Subjektet në zbatim të pikës 6, neni 56 dhe nenit 74 të Ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastet mbajtësi i licencës dhe/ose autorizimit, hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e licencuar/autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, për miratimin një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje, duhet dorëzoi dokumentacionin provues për miratimin e aplikimit.
2. Në rastet kur AMA e miraton kalimin e të drejtave që rrjedhin nga licenca ose autorizimi sipas kësaj rregulloreje, brenda 30 ditëve nga miratimi i ndryshimeve, aplikuesi për miratimin e një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje, duhet të dorëzoi pranë AMA-s aplikimin e ri, në përputhje me kërkesat dhe afatet e rregulloreve në fuqi për pajisjen me autorizim dhe licencë.
3. Nëse AMA, nuk e miraton kalimin, për shkaqe të parashikuara në këtë rregullore, licenca dhe/ose autorizimi bëhet e/i pavlefshëm, në rastet kur vëren se nuk plotësohen kushtet e nenit 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Heqja dorë nga ushtrimi i veprimtarisë audio/audiovizive

5. Në rast se personi juridik kërkon të heqë dorë nga ushtrimi i veprimtarisë audio/audiovizive pas procedurës së bashkimit me përthithje, ose në rast se kërkon të mos i shqyrtohet kalimi i drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizim prej AMA-s, duhet të paraqesë, së bashku me aplikimin sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje:
 - a. Kërkesën me shkrim për heqje dorë të veprimtarisë audio/audiovizive
 - b. Ekstraktin e thjeshtë të QKB-së ku në objektin e veprimtarisë së subjektit të mos jenë më të përfshira shërbimet në fushën e shërbimeve audiovizive.
6. Në këtë rast, AMA konstaton pavlefshmërinë e licencës/autorizimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar dhe pikës 2 të nenit 8, si më sipër.

KREU IV

PROCEDURA E SHQYRTIMIT DHE VENDIMMARRJES

Neni 11

Procedura e shqyrtimit të aplikimit

1. Aplikimet për ndryshime të strukturës pronësore administrohen në prani të Komisionit për Shqyrtimin e Dokumentacionit, ngritur me Urdhër të Kryetarit të AMA-s, dhe merren në shqyrtim vetëm dosjet e aplikimit që rezultojnë të mbyllura dhe të vulosura. Komisioni

verifikon nëse subjekti ka kryer pagesën përkatëse dhe në rast se subjekti nuk ka kryer pagesën, dosja e aplikimit të tij nuk i nënshtrohet shqyrtimit dhe arkivohet.

2. Pas verifikimeve të kushteve të pikës 1 të këtij neni, vijon identifikimi i të gjithë dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.
3. Informacioni në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.
4. Aplikimi i subjektit, dokumentacioni i të cilit, rezulton në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, shqyrtohet në mënyre tërësore nga grupi i punës dhe i nënshtrohet vendimmarrjes në mbledhjet e AMA-s. Në rast se dokumentacioni nuk është konform dispozitave të sipërpërmendura, subjekti aplikues njoftohet brenda 15 ditëve për plotësimin e tij. Nëse pas kalimit të këtij afati, subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin përkatës, KSHD i propozon AMA-s rrëzimin e aplikimit.
5. AMA miraton procedurën e ndjekur të vlerësimit dhe në rast se konstaton mangësi në respektimin e tyre, ka të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.

Neni 12 **Vendimmarrja e AMA-s**

1. Vendimi për miratimin ose jo të ndryshimeve në strukturën e pronësisë jepet nga AMA jo më vonë se 30 ditë, duke filluar ky afat nga data e përcaktuar për depozitimin e aplikimit.
2. Ky afat nuk vlen për rastet kur aplikimi është me mangësi në dokumentacion.
3. Kundër vendimit të AMA-s, për rrëzimin e kërkesës për ndryshime në strukturën e pronësisë, mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Nëse AMA nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në ligj, aplikuesi njofton brenda 15 ditëve QKB-në për refuzimin e miratimit të ndryshimeve në strukturën pronësore dhe kërkon rikthimin e pjesëmarrjes në kapital në gjendjen e mëparshme.

KREU V **DEKLARIMI I PRONËSISË, PRONARIT PËRFITUES DHE SANKSIONET NË RASTE** **MOSDEKLARIMI**

Neni 13 **Publikimi i strukturës pronësore në Regjistrin e Pronësisë së OSHMA-ve**

1. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive bëjnë publik informacionin në faqet e tyre zyrtare në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues.
2. AMA administron, publikon dhe përditëson Regjistrin e Pronësisë së OSHMA-ve në faqen zyrtare të Autoritetit, bazuar në të dhënat e deklaruara nga OSHMA-ja dhe pronarët përfitues të tyre.
3. Regjistri përmban:
 - a. Të dhëna mbi emrin e personit juridik OSHMA;
 - b. Llojin dhe statusin e personit juridik OSHMA;
 - c. Periudhën e marrjes/rinovimit të licencës ose autorizimit në AMA;

- d. Emrat, detajet dhe përqindja e pronësisë së aksionarëve/ortakëve pjesëmarrës në kapital;
 - e. Emrat, detajet dhe përqindja e pronësisë së pronarëve përfitues
 - f. Llojin e pronësisë së pronarëve përfitues (direkte ose indirekte)
4. AMA ka të drejtë të kërkojë informacion nga QKB-ja apo institucione të tjera publike përgjegjëse, në rastet kur të dhënat e regjistruara në Regjistër nuk përputhen me të dhënat në posedim të institucioneve në fjalë.
 5. Nëse AMA konstaton se të dhënat e regjistruara në Regjistër nuk përputhen me të dhënat e publikuara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues të QKB-së, atëherë:
 - a) AMA njofton në mënyrë shkresore personin juridik OSHMA dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - b) personi juridik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të AMA-s duhet të deklarojë të dhënat e sakta për strukturën pronësore dhe pronarët përfitues, sipas ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar,
 - c) në rast se subjekti raportues nuk përditëson ose nuk konfirmon të dhënat për pronarët e tyre përfitues brenda 15 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të AMA-s, ky veprim përban kundërvajtje administrative sipas nenit 133, pika 2 (d) të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar dhe AMA ka të drejtë të vendosë gjobë.
5. Krahas pikës 2, AMA publikon informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj, përfshirë pronarët përfitues, sipas pikës 2 të këtij neni, çdo gjashtë muaj, edhe në Buletinin periodik të Autoritetit.

Neni 14 **Publikimi i volumit të reklamave**

AMA publikon të dhëna mujore mbi volumin tërësor të reklamave të transmetuara nga OSHMA-të, në bazë të monitorimit që kryen sipas nenit 4, pika 11 të kësaj rregulloreje, përfshirë informacion mbi volumin e reklamës politike dhe institucionale në OSHMA-të kombëtare.

Neni 15 **Gjobat**

1. Mungesa e njoftimit në AMA nga OSHMA-ja e licencuar/ autorizuar për ndryshimet në strukturën pronësore, apo ndryshime në të dhëna të tjera të licencës/autorizimit sipas nenit 8, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 120 000 deri në 2 000 000 lekë.
2. Gjoba vendoset nga AMA kryesisht, ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.

KREU VI **BASHKËPUNIMI ME PALË TË TRETA PËR SIGURIMIN E TRANSPARENCËS SË** **PRONËSISË NË TREGUN AUDIO/AUDIOVIZIV**

Neni 16 **Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës**

1. AMA mund të kërkojë bashkëpunim ose ndihmë të ndërsjellë me Autoritetin e Konkurrencës, për qëllime të shkëmbimit të informacionit ose marrjen e masave të rëndësishme, për zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të kësaj rregulloreje.
2. Nëse AMA gjykon se ekziston një rrezik serioz dhe i rëndë që çënon funksionimin e tregut të brendshëm për shërbimet e medias audiovizive, mund t'i kërkojë autoriteteve ose organeve të tjera rregullatore kombëtare të ofrojnë bashkëpunim të ndërsjellë, duke siguruar njëkohësisht respektimin e të drejtave themelore, në veçanti lirinë e shprehjes.
3. Kërkesat për bashkëpunim të ndërsjellë, përfshirë bashkëpunimin e përsheptuar ose ndihmën e ndërsjellë, përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, së bashku me qëllimin dhe arsyet për të.

Neni 17

Bashkëpunimi me autoritetet homologe evropiane rregullatore

AMA mund të shkëmbejë eksperiencën dhe praktikat më të mira me autoritetet homologe të shteteve të tjera, me platformën evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA) dhe me grupin e rregullatorëve evropianë për shërbimet mediatike audiovizive (ERGA) në kuadër të zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

Shqyrtimi i aplikimeve

Aplikimet për ndryshime në pronësi apo kalim të të drejtave që rrjedhin nga licenca/autorizimi, të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, por për të cilat AMA nuk është shprehur ende me vendimmarrje, do të shqyrtohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së aplikimeve.

Neni 19

Parashikime për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove (OPSHV)

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen edhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet dhe kufizimet e ligjit në fuqi për mediat audiovizive.

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).
2. Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Shtojcë nr. 1
Formular aplikimi

NJOFTIMI PËR NDRYSHIM TË STRUKTURËS SË PRONËSISË:

Pala kërkuese: _____
(emri i plotë i OSHMA-së)

NIPT (numri i identifikueshëm): _____
Adresa dhe selia e regjistruar:

Kontakt: _____

GJENDJA AKTUALE E STRUKTURËS SË PRONËSISË PËRPARA NDRYSHIMIT:

Emër, mbiemër/emër tregtar _____
NIPT _____
Adresa dhe selia e regjistruar:

Lloji i ortakut/aksionarit: Person Fizik Person Juridik

Pjesëmarrja në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)
2) _____ (në %)
3) _____ (në %)

TË DHËNA PËR PRONARIN PËRFITUES MBI PERSONIN JURIDIK OSHMA
PËRPARA NDRYSHIMIT:
(vetëm për persona fizikë)

Emër, mbiemër _____
NUIS _____
Adresa: _____
Kontakt: _____

Pjesëmarrja në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)
2) _____ (në %)
3) _____ (në %)

Lloji i pronësisë: Direkte Indirekte

NDRYSHIMI I PLANIFIKUAR I STRUKTURËS SË PRONËSISË:

Pala e larguar:

Emër, mbiemër/emër tregtar _____

NIPT _____

Adresa dhe selia e regjistruar:

Lloji i ortakut/aksionarit të loarguar: Person Fizik Person Juridik

Pjesëmarrja e larguar nga kapitali i OSHMA-së: 1) _____ (në %)

2) _____ (në %)

3) _____ (në %)

Pala e re pjesëmarrëse:

Emër, mbiemër/emër tregtar _____

NIPT _____

Adresa dhe selia e regjistruar:

Lloji i ortakut/aksionarit të ri: Person Fizik Person Juridik

Pjesëmarrja e re në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)

2) _____ (në %)

3) _____ (në %)

Mënyra e transferimit të pronësisë: Shitblerje Dhurim Tjetër (Lutemi specifikoni:

_____)

STRUKTURA E PRONËSISË QË REZULTON NGA NDRYSHIMI I KËRKUAR:

Emër, mbiemër/emër tregtar _____

NIPT _____

Adresa dhe selia e regjistruar:

Pjesëmarrja në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)

2) _____ (në %)

3) _____ (në %)

Informacion mbi origjinën e burimeve financiare të transaksionit tregtar (për t'u plotësuar nga pala blerëse):

**TË DHËNA PËR PRONARIN PËRFITUES MBI PERSONIN JURIDIK OSHMA PAS
NDRYSHIMIT:**

(vetëm për persona fizikë)

Emër, mbiemër _____

NUIS _____

Adresa: _____

Kontakt: _____

Pjesëmarrja në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)

2) _____ (në %)

3) _____ (në %)

Lloji i pronësisë: Direkte Indirekte

DEKLARIME TË TJERA NGA PALËT:

Informacion për konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në organizata të tjera ose shoqëri private, në rastet kur kjo ndikon drejtpërdrejtë në ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive:

Po (Nëse po, lutemi specifikoni më poshtë)

Jo

Informacion mbi sponsorizime, reklama, donacione, investime, nga persona juridikë publikë, me qëllim promovimi të tyre:

Po (Nëse po, lutemi specifikoni më poshtë)

Jo

(Vendndodhja), më _____ (data)

(hapësirë për vulën)

(emër, mbiemër)

Administratori

Shtojcë nr. 2
Formular aplikimi

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIM TË TË DHËNAVE TË TJERA TË
LICENCËS/AUTORIZIMIT:**

Pala kërkuese: _____
(emri i plotë i OSHMA-së)

NIPT (numri i identifikueshëm): _____

Adresa dhe selia e regjistruar:

Kontakt: _____

Lloji i ortakut/aksionarit: Person Fizik Person Juridik

Pjesëmarrja në kapitalin e OSHMA-së: 1) _____ (në %)

2) _____ (në %)

3) _____ (në %)

Lloji i ndryshimit të kërkuar (lutemi specifikoni më poshtë):

(Vendndodhja), më _____ (data)

(hapësirë për vulën)

_____ (emër, mbiemër)

Administratori